

### Programi iii: Novacioni dhe e ardhmja dixhitale

*Në Barleti Grup dhe Universitetin Barleti, programi i novacionit është një term ombrellë për programet dhe projektet që UniBa dhe institutet e atashuara krijojnë, me qëllim përcjelljen e risive të reja te organizatat dhe ndërtimin e aftësive të tyre të novacionit. Programi i novacionit të UniBa përbëhet nga një numër nismash të veçanta, por të ndërthurura të novacionit, siç janë laboratorët e novacionit, programet e sipërmarrjes, qendrat e ekselencës (CoE), akseleratorët dhe qendrat e tjera.*

Në Barleti Grup dhe Universitetin Barleti, programi i novacionit është një term ombrellë për programet dhe projektet që UniBa dhe institutet e atashuara krijojnë, me qëllim përcjelljen e risive të reja te organizatat dhe ndërtimin e aftësive të tyre të novacionit

Termi novacion është përdorur shpesh për t'iu referuar projekteve individuale, por UniBa e gjykon programin e novacionit si misioni i organizimit të nismave të UniBa dhe Grupit Barleti dhe të organizatave me të cilat këta të fundit ndërveprojnë. Ata synojnë krijimin e novacionit, në një tërësi kohezive në realitetin ekonomik dhe social shqiptar. Programi i novacionit të UniBa përbëhet nga një numër nismash të veçanta, por të ndërthurura të novacionit, siç janë laboratorët e novacionit, programet e sipërmarrjes, qendrat e ekselencës (CoE), akseleratorët dhe qendrat e tjera. Të gjitha programet e suksesshme të novacionit janë njëloj, në kuptimin që ata arrijnë të ndërtojnë një sistem ku lulëzon risia, dhe ku nuk ka ndonjë pengesë kryesore që parandalon të ndodhë novacioni. Qëllimi i programit të inovacionit të UniBA është të inkurajojë individët me të cilët bashkëpunon (stafin e universitetit, studentët, startupet, donatorët, organizatat dhe ekspertët e jashtëm të projekteve) të krijojnë ide - t'u japin atyre mundësinë të krijojnë idetë e tyre, të sigurojnë kapital eksperimental për individët, të testojnë idetë dhe pastaj të investojnë në ato të suksesshmet.

Në mënyrë që novacioni dhe e ardhmja dixhitale të bëhen pjesë e kulturës, hapja ndaj eksperimentimit të disiplinuar dhe pasigurisë është një domosdoshmëri. Mbi të gjitha, kërkon një gadishmëri për të sfiduar supozimet që mund ta kenë bërë biznesin apo institucionin të suksesshëm në radhë të parë. Dhe, për të dhënë rezultate domethënëse dhe të besueshme, një iniciativë e novacionit dhe e së ardhmes dixhitale duhet të jetë e lidhur në mënyrë të qartë me strategjinë dhe qëllimet e organizatës apo biznesit që e ndërmerr. Qasja e programit të novacionit UniBa trajnon drejtuesit që të lejojnë, përqafojnë dhe praktikojnë zhvendosjet e kërkuara për të krijuar një kulturë në të cilën mund të lulëzojnë novacioni dhe e ardhmja dixhitale.

UniBa ndërmerr një proces me tre hapa drejt inovacionit dhe të ardhmes dixhitale:

- Identifikimi i problemit që do të zgjidhet: UniBa, nëpërmjet këtij programi, krijon partneritet për të gjetur rezultatet që biznesi apo organizatat dëshirojnë të arrijnë përmes inovacionit dhe të ardhmes dixhitale. Bazuar në këtë, programi rekomandon një qasje që fillon me sigurimin që të ekzistojë një kulturë e fortë novacioni.
- Ndërtimi i një kulture dhe aftësive: Programi mëson mënyra të reja për të bërë dhe udhëhequr inovacionin dhe të ardhmen dixhitale duke përdorur përvoja dhe mjete të



personalizuara të cilat mund të mësohen shpejt nga kontribuesit, ekipet dhe liderët me eksperiencë.

- Zgjerimi i ndikimit: Për të zgjeruar aftësinë e të mësuarit dhe përvetësimin me kalimin e kohës, programi ofron një suitë të mjeteve, praktikave dhe trainimeve për ndihmë të performancës "në terren" për pjesëmarrësit. Rezultati përfundimtar është një praktikë e vetme dhe një udhëtim mbështetës që ndihmon liderët të zhvillojnë besimin dhe zakonet e nevojshme për të zhvilluar dhe përhapur një kulturë inovacioni në mënyrë të vendosur.

Novacioni dhe e ardhmja dixhitale janë një proces dhe një mentalitet. Në thelb pra, është një mënyrë për të zbuluar dhe zgjidhur problemet; një proces që fillon me disa nocione jo të zakonshme. Së pari, programi fillon duke e lidhur novacionin dhe mendimin e projektimit me objektivat strategjike. Së dyti, procesi nuk fillon me specifikimet e produktit ose hulumtimin tradicional të marketingut; fillon me zbulimin dhe empatinë për përdoruesit për të cilët po sillet novacioni.

Revolucioni dixhital sjell shumë mundësi për ndërmarrjet e mëdha dhe të vogla, por shumë prej tyre ende e kanë të vështirë të dinë se në cilat teknologji të investojnë dhe si të sigurojnë financime për transformimin e tyre dixhital.

## Çfarë ofron programi?

- *Kuptimi i rolit të Përdoruesit/User-it*

Programi i novacionit të UniBA përqëndrohet në gamën e plotë të aftësive krijuese, teknikave, sistemeve dhe sjelljeve drejtuese që lëshojnë potencialin krijues. Si rezultat, kjo lejon biznesin dhe organizatat të qëndrojnë konkurrues në tregun global me hapa të shpejtë. Për shumë kohë, përqëndrimi ka qenë kryesisht në produkte ose shërbime, duke besuar se investimi në teknologji dhe operacione të reja do të krijojë risi por vetëm investimi në njerëz mund ta bëjë këtë.

- *UniBa për biznesin*

Përmes trajnimeve, dëshirojmë që biznesi apo organizatat e ndryshme të gjejnë një program novacioni që përputhet me qëllimet e tyre. UniBa ofron lehtësim përmes praktikave më të mira të inovacionit hap pas hapi. Cdo aktivitet është krijuar për të ndërtuar një kulturë më inovative dhe bashkëpunuese, po ashtu, me ide dhe strategji të reja për t'u ndjekur.

- *Akademia e Inovacionit UniBa*

Akademia e Inovacionit të UniBA është e specializuar në Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë (STEM). E dizajnuar në mënyrë unike për të integruar shkencat në të gjitha aspektet e të mësuarit, do t'i angazhojë studentët mbi kurrikulën dhe udhëzimet përkatëse që do të përdorin teknologjinë dhe kreativitetin për të pasuruar dhe inkurajuar mësimin. Kjo akademi do të përmirësojë aftësitë dhe përvojat e studentëve në zgjidhjen e problemeve në botë, duke u dhënë atyre aftësi dhe njohuri të Shekullit 21. Standardet e larta akademike, mjedisi i bashkëpunimit të të mësuarit dhe partneriteti në komunitet do të sigurojnë që çdo student të ketë qasje të barabartë, të përmirësojë zhvillimin intelektual dhe social.

- *Qendra E Konsulencës së Novacionit dhe Teknologjisë në UniBa*



Qendra kryesore e novacionit dhe teknologjisë të UniBa është vendi ku idetë kthehen në realitet. Është një vend ku ekspertët e UniBa-s ndërmarrin sfidat më të mëdha të klientëve dhe i ndihmojnë ata në çdo hap të rrugëtimit drejt novacionit, nga realizimi i prototipit deri tek dalja e tyre në treg. Ekspertët e UniBa-s punojnë në sfida komplekse të klientit në një varg disiplinash nga inxhinieria deri në hartimin e produkteve të reja dhe strategjitë e fillimit.

- *Institutet- aktorë partnerë në Progamim e Novacionit dhe Të Ardhmes Dixhitale*

Institutet, pjesë e Grupit Barleti, synojnë kryerjen dhe promovimin me cilësi të lartë të kërkimeve shkencore të aplikuara. Ato promovojnë vlerat dhe praktikat demokratike, angazhohen për ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve aktivë, monitorojnë dhe analizojnë strategjitë dhe politika të ndryshme, ofrojnë konsulencë dhe ekspertizë të kualifikuar dhe të pavarur për çështje politike, sociale, ekonomike dhe ligjore që lidhen drejtpërdrejt me interesin publik dhe me zhvillimin e vendit. Institutet e UniBa-së janë aktivë në promovimin dhe zbatimin e projekteve për një zhvillim inteligjent dhe novativ të kombinuar me elementë arsimorë, artistikë dhe kulturorë, në mënyrë që shoqëria të përfitojë dhe të zhvillohet.

### **Qëllimet e identifikuara të këtij programi:**

Te mësuarit e procesit krijues dhe aftësisë së të menduarit rreth projektimit te novacionit nëpërmjet gjetjes së:

- Metodologjisë dhe kornizave të novacionit
- Mjeteve dhe teknikave të përdorimit të tij
- Aplikimi për t'ju përgjigjur sfidave reale të tregut të punës

### **Partneriteti i Helikes së Pesëfishtë (Quintuple Helix):**

- Përdoruesi/User-i
- Biznesi
- Autoritete qeverisëse lokale apo kombëtare
- Akademia e Novacionit në Universitetin Barleti
- Shoqëria Civile

Elementët kryesore për ndërtimin e një ekosistemi që përqafon filozofinë e novacionit të hapur (open innovation) ndërmjet universitetit, bizneseve dhe autoriteteve qeverisëse, me përparim në plotëkuptimin e novacionit, rëndësisë së tij dhe lehtësimeve për të mundësuar format dhe llojet e ndryshme në sipërmarrjet, organizatat apo insitucionet në Shqipëri janë:

- Zinxhiri i vlerës së novacionit: promovimi i konceptit të novacionit
- Rritja e kapacitetit të biznesit lokal për të krijuar novacion
- Rëndësia e bashkëpunimit në quadruple helix për rritje kapaciteti mbi novacionin

### **Linjat e veprimit të PROGRAMIT: Qendrat dhe Laboratorët Universitar për Sipërmarrje, Kreativitet dhe Novacion:**



- **Hub-et e Novacionit** të krijuara në UniBa sjellin së bashku një bashkësi novatorësh dhe sipërmarrësish me mendësi të ngjashme. Ndërsa inkubatorët tradicionalë të biznesit zakonisht fokusohen në objektivat e rritjes financiare, hub-et e novacionit shpesh theksojnë ndjenjën e një misioni të përbashkët, zakonisht në formën e 'ndikimit' që anëtarët e tyre përpiqen të kenë dhe përcjellin.
- **Qendrat e Ekselencës.** Këto institucione sipërmarrëse ndërdisiplinore në UniBA veprojnë si qendra të integruara të njohurive dhe përbëhen nga funksione të shumta. Qendrat e Ekselencës së UniBa mund të veprojnë gjithashtu si qendra që merren me përsosjen e novacionit të modelit të biznesit të kompanive që bëhen pjesë e rrjetit të tyre.
- **Lab-et e Novacionit** të UniBa-së fokusohen në gjetjen e mjeteve dhe mënyrave që mund të ndihmojnë në rritjen e biznesit. Këto mund të jenë të brendshme për një formë të korporatës që ka burimet dhe ekipin në dispozicion për të drejtuar programet e tyre të brendshme, ose mund të përdoren nga OJF-të për të inkurajuar novacionin brenda organizatave të tyre.
- **Hub-et Dixhitale të Novacionit (HDI)** në UniBa mund të ndihmojnë në sigurimin që çdo kompani, e vogël apo e madhe, e teknologjisë së lartë apo jo, të përfitojë nga mundësitë dixhitale. HDI janë njësi që ndihmojnë kompanitë të bëhen më konkurruese në lidhje me proceset e biznesit / prodhimit të tyre, produkte ose shërbime duke përdorur teknologji dixhitale. HDI sigurojnë qasje në ekspertizë teknike dhe eksperimente, në mënyrë që kompanitë të mund "të provojnë përpara se të investojnë". Ato gjithashtu ofrojnë shërbime të inovacionit, të tilla si këshilla për financimin, trajnim dhe zhvillim të aftësive që janë të nevojshme për një transformim të suksesshëm dixhital.

## **Paketat e punës: WORKSHOPE TRAJNUESE MBI NOVACIONIN**

1. Workshopet e novacionit bashkëpunues
2. Workshop trajnues mbi "Design Thinking"
3. Programi "Trajno Trajnuesin"
4. Mendësia për novacionin
5. Workshop mbi të menduarin strategjik
6. Workshop mbi kulturën novative "Agile"
7. Workshop mbi liderat novativë
8. Novacioni nga pikat e forta të kompanisë
9. Krijimi i produkteve dhe shërbimeve të reja
10. Fillimi i projektit novator